



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 12-681 /2026

Klinë, datë 08/01 /2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare, nr. 28/2008 publikuar më dt.04.06.2008, dispozitat e nenit 9,10 dhe 12 të Rregullores nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dispozitat e nenit 90 të Ligjit, Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.22/2011, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të miratuar me datën 31.03.2010, më propozimin e DSHPE, Kryetari i Komunës së Klinës, merr këtë;

V E N D I M

Për formimin e komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore

- FORMOHET**, komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Klinës. Përbërja e komisionit është, siç vijon:
 - 1.1. Visar Bojaj, ing. i arkitekturës, kryesuese;
 - 1.2. Adnan Zeneli, Jurist, sekretar;
 - 1.3. Rexhep Gashi, ing. komunikacionit, anëtarë;
 - 1.4. Leotrim Dauti, përf. nga drejtoria e Bujqësisë, anëtare, si dhe;
 - 1.5. Shendrit Gashi, koordinator.
- Mandati i komisionit komunal- lokal për vlerësimin e dëmeve është katër (4) vite.
- Komisioni si nga pika 1 e këtij vendimi detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron, bazuar në Ligjin, nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Rregulloren, nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe aktet tjera pozitive.
- Komisioni në përputhje me dispozitat e Rregullores, përpilon Raportin përmbledhës për dëmet e vlerësuara në territorin e komunës dhe i'a dorëzon kryetarit të komunës për shqyrtim.
- Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë, ku me rastin e hyrjes në fuqi të tij shfuqizohet vendimi, nr.01-325-39855/2022 i datës 23.11.2022 së bashku me plotësimet e ndryshimet e tij.

Të njoftohen:

- Të përmendurit;
- Komisioni Qeveritar për vlerësimin e Dëmeve;
- Ekzekutivi, DSHPE;
- Zyra e Informimit;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

❖ **KOMUNA E KLINËS**

❖ **DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENTE**

- **PËR:** Z. Zenun Elezaj, Kryetar i Komunës së Klinës
- **NGA:** Z. Qendrim Millaku, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjente
- **LËNDA:** Propozim për formimin e Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore
- **DATA:** 08.01.2026.

ARSYETIMI

Si pasojë e vërshimeve që kanë prekur territorin e Komunës së Klinës, është e domosdoshme ndërhyrja institucionale për evidentimin dhe vlerësimin profesional të dëmeve në ekonomitë familjare, infrastrukturë dhe bujqësi. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar transparencë, saktësi dhe për të përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për kërkesa për kompensim në nivel qendror (Qeveria e Kosovës).

PROPOZIMI I PËRBËRJES SË KOMISIONIT

Propozoj që Komisioni të përbëhet nga 5 anëtarë, duke përfshirë ekspertë të fushave përkatëse:

DETYRAT E KOMISIONIT

- Të dalë në terren për inspektimin e zonave të prekura.
- Të mbledhë dhe të verifikojë kërkesat e qytetarëve për dëmet e shkaktuara.
- Të hartojë një raport final me llogaritje financiare të dëmeve sipas çmimeve të tregut.

Me respekt.

Qendrim Millaku

Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjente

Komuna e Klinës